

VENDIM
Nr.668, datë 21.1.2008

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KOMBËTAR
“TV TOP CHANNEL”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe rregullores me kriteret “Për dhënien e licencave për transmetime televizive analoge tokësore në nivel kombëtar”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Top Channel” sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kombëtar në fushën e transmetimeve analogjike tokësore për një periudhë prej 8 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen, struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Licenca me nr.049/TVL, për operatorin televiziv privat vendor “Top Channel”, bëhet e pavlefshme.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)